



**CENTRE FOR
LEGAL EMPOWERMENT**

Nr 1 Prot
Datë 31.01.2023



**MINISTRIA E DREJTËSISË
DREJTORIA E NDIHMËS
JURIDIKE FALAS**

Nr. 276 Prot
Datë 31.01.2023

MARRËVESHJE MIRËKUPTIMI

NDËRMJET

ORGANIZATËS “CENTRE FOR LEGAL EMPOWERMENT” (CLE)

DHE

DREJTORISË SË NDIHMËS JURIDIKE FALAS

“Për sigurimin e aksesit në drejtësi të qytetarëve nëpërmjet ofrimit të shërbimit të ndihmës juridike falas, sipas përcaktimeve të ligjit nr.111/2017 «Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti ””

Kjo marrëveshje bashkëpunimi lidhet sot më datë 31/01/2023

NDËRMJET

Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas me adresë: Rruga “Jordan Misja”, Godina nr. 3, Tiranë, përfaqësuar nga z. Ergys Qirici, Drejtor i Përgjithshëm.

Dhe

Organizatës jofitimprurëse “Centre For Legal Empowerment” (CLE) me adresë: Rruga “Qemal Stafa”, Tiranë, përfaqësuar nga z. Franc Terihati, Drejtor Ekzekutiv.

Ndërkohë që:

Organizata jofitimprurëse “Centre For Legal Empowerment” (CLE) ka për qëllim të kontribuojë garantimin e aksesit në drejtësi për kategoritë vulnerabël në Republikën e Shqipërisë nëpërmjet mbështetjes së Klinikave të Ligjit në cilësinë e ofruesve të shërbimit të ndihmës juridike parësore; garantimit të ndihmës juridike online nëpërmjet platformës “*juristionline.al*” si dhe ndërmarrjes së hapave konkretë në drejtim të rregullimit ligjor të profesionit të paraligjorit në Republikën e Shqipërisë;

Në kuadër të përmirësimit të funksionimit të sistemit të ofrimit të ndihmës juridike parësore, *Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas*, institucioni kryesor përgjegjës për administrimin e sistemit të ndihmës juridike të garantuar nga shteti, në bashkëpunim me institucionet e tjera dhe organizatat e shoqërisë civile synon ndërmarrjen e hapave reale për rritjen e aksesit në drejtësi të qytetarëve dhe në veçanti të grupeve vulnerabël;

Palët bien dakord si më poshtë:

Neni 1

Organizata jofitimprurëse “Centre For Legal Empowerment” (CLE) do të bashkëpunojë me Drejtorinë e Ndihmës Juridike Falas për:

- Ofrimin e shërbimit të ndihmës juridike online nëpërmjet platformës “*Juristionline.al*”;
- Mbështetjen e Klinikave të Ligjit pranë IAL-ve, ofruese të shërbimit të ndihmës juridike parësore nëpërmjet projekteve të përbashkëta;
- Ndërmarrjen e masave në drejtim të propozimeve për rregullimin ligjor të paraligjorit në Republikën e Shqipërisë;
- Zhvillimin e trajnimeve fillestare dhe të vazhdueshme për paraligjorët e angazhuar pranë ofruesve të ndihmës juridike parësore;
- Çdo aktivitet tjetër të dakordësuar midis palëve me fokus garantimin e ndihmës juridike falas për kategoritë vulnerabël.

Neni 2

Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas vlerëson dhe mbështet organizatën “Centre For Legal Empowerment” (CLE) përmes:

- Angazhimit të punonjësve të qendrave të shërbimit të ndihmës juridike parësore në kthimin e përgjigjeve në platformën “juristionline.al” në rubrikën shërbime ligjore pa pagesë;
- Promovimin e shërbimit të ofruar nga Klinikat e Ligjit të mbështetura nga organizata “Centre For Legal Empowerment” (CLE);
- Ndërmarrjen e hapave të përbashkëta në drejtim të propozimeve për rregullimin ligjor të paraligjorit në Republikën e Shqipërisë dhe përfshirjes së paraligjorëve si pjesë e skemës së ofruesve të shërbimit të ndihmës juridike parësore;
- Mbështetjen e organizatës në drejtim të dhënies së ekspertizës dhe zhvillimit të trajnimeve fillestare dhe të vazhdueshme për paraligjorët e angazhuar pranë ofruesve të ndihmës juridike parësore;
- Çdo aktivitet tjetër të dakordësuar midis palëve me fokus garantimin e ndihmës juridike falas për kategoritë vulnerabel.

Neni 3

Platforma “Juristionline.al” është një nisëm e organizatës “Centre for Legal Empowerment”. Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas nuk disponon të drejta pronësie këtë platformë por jep kontributin e saj nëpërmjet angazhimit vullnetar të punonjësve të Qendrave të Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore në kthimin e përgjigjeve të adresuara në platformë në rubrikën “Shërbime ligjore pa pagesë”.

Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas nuk merr përsipër angazhimin në rubrikën “Shërbime ligjore me pagesë” në kushtet kur kjo formë e ofrimit të ndihmës juridike bie ndesh me objektin e ligjit nr. 111/2017, “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti” dhe detyrat funksionale të institucionit.

Neni 4

Kjo marrëveshje mirëkuptimi hyn në fuqi me nënshkrimin e saj dhe nuk është objekt i detyrimeve financiare për palët.

Mosmarrëveshjet që mund të lindin mes palëve zgjidhen me frymën e mirëkuptimit dhe me biosedime ndërmjet tyre.

Për Drejtorinë e Ndhmës
Juridike Falas

Për organizatën “Centre For
Legal Empowerment” (CLE)

Z. Ergys Qirici
Drejtor i Përgjithshëm



Z. Franc Terihati
Drejtor Ekzekutiv



Centre for Legal
Empowerment
www.cle.al